



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1247/2 Prot.

Tiranë, më 30 / 09 / 2020

V E N D I M

Nr. 116, Datë 30 / 09 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 97, datë 17.09.2020, të paraqitur nga F.J kundër Bashkisë Këlcyrë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “vendbanimit” dhe “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga F.J, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna,¹subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Këshilli Bashkiak Këlcyrë me Vendimin Nr. 33, datë 29.08.2005, ka vendosur të miratojë dhënien e sheshit të ndërtimit për objektin lokal plus banesë, F.J, me sipërfaqe 143 m², sipërfaqe ndërtimi 112 m², duke u bazuar në Vendimin Nr. 2, datë 22.06.2005 të KRRT-së Bashkisë Këlcyrë, për miratimin e studimit urbanistik pjesor. Me Vendimin nr. 1, datë 05.04.2006 të KRRT-së së Bashkisë Këlcyrë, është pajisur me leje ndërtimi për të ndërtuar objektin e sipërpërmendur lokal plus banesë dy kate, plus kat nëntokë me një afat kohor deri në 05.04.2011. Ka ndërtuar brenda afateve kohore të lejes së ndërtimit katin nëntokë në fazën karabina të objektit lokal plus banesë 2+1 kate. Për shkak të largimit të tij familjarisht për në SHBA dhe për arsye të bllokimit të ndërtimeve të reja nga ana e qeverisë për vite me radhë nuk ka mundur t’i përfundojë punimet në kohë.*

¹ Shpjegimet e dhëna në formularin e ankimit dhe informacionit të dërguar me email datë 24.09.2020.

Veprimet e Bashkisë Këlcyrë lidhur me kërkesat dhe veprimet e tij për objektin lokal plus banesë, miratuar me vendim të KRRT-së të Bashkisë Këlcyrë me Vendim nr 1, datë 05.04.2006, kanë qenë jo vetëm refuzuese, por dhe diskriminuese, si më poshtë vijon:

1. Bashkia Këlcyrë refuzon shitjen e pjesës së mbetur të truallit 50% të sheshit të ndërtimit të objektit lokal plus banesë, për F.J, ndërsa për qytetarë të tjerë ka kryer kontrata shitblerje trualli, duke qenë në të njëjtat kushte me F.J, ndërtues në zonën tregëtare të lulishtes qendër dhe përfitues për të ndërtuar në zonën tregëtare të lulishtes qendër Këlcyrë, nga i njëjti plan urban për zonën tregëtare të lulishtes qendër Këlcyrë.

2. Për tre mandatet e kryetarit të Bashkisë Këlcyrë, bashkia nuk ka dërguar dokumentacionin për regjistrimin e lejes së ndërtimit të në ZVRrPP Përmet, për objektin e tij, të miratuar me Vendim nr. 1, datë 05.04.2006 të KRRT-së Bashkisë Këlcyrë, duke e lënë të cilësohet si objekt i paligjshëm, kur ndërtuesit e tjerë në zonën tregëtare të lulishtes qendër Këlcyrë figurojnë me pronë të regjistruar, që do të thotë se jo vetëm ju është regjistruar leja e ndërtimit, objekti, por është bërë dhe kontrata e shitblerjes së truallit që është regjistruar trualli.

3. Bashkia Këlcyrë refuzon dërgimin e dokumentacionit në ZVRrPP Përmet për regjistrimin e objektit të F.J në fazën karabina kat nëntokë, kur objekti i T.Z në të njëjtën gjendje ndërtimi, kufitar i rrethit të dytë me F.J, pjesë e zonës tregëtare të lulishtes qendër Këlcyrë, rezulton me dokument pronësie. Për regjistrimin e pronës së T.Z, Bashkia Këlcyrë ka patur detyrimin ligjor të përcjelljes së dokumentacionit ZVRrPP Përmet.

4. Bashkia Këlcyrë kërkon prishjen e katit nëntokë të objektit të F.J duke pretenduar në gjykatë se nuk ka kat nëntokë, kur për objektet e tjerë në kufi me F.J, të cilët kanë të njëjtin ndërtim me kat nëntokë për shkak të relievit, dhe janë të miratuara me leje ndërtimi nga KRRT e Bashkisë Këlcyrë si objekti i F.J, nuk e ka një pretendim të tillë, pasi rezultojnë të regjistruar në ZVRrPP Përmet.

5. Bashkia Këlcyrë nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të projektit “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër”, ka bërë trajtim të diferencuar duke i legalizuar, zaptuesve të pronës publike, servitutit publik, me ndërtime të paligjshme, zgjerim objekti, në zonën tregëtare të lulishtes qendër Këlcyrë, kufitarë me F.J dhe jo kufitare me F.J, pa dhënë asnjë justifikim për karakteristikat objektive që lidhen me këtë trajtim të diferencuar, ndërsa për objektin e F.J që është korrekt me lejen e ndërtimit kërkon prishjen e objektit dhe zëvendësimin e tij me pedonale, pa kërkuar zgjidhje projektuese në këto hapësira të zaptuesve të pronës publike, pa zbatuar parimin e proporcionalitetit për cenimin me pak të pronarëve që janë në kushte të njëjta objektive dhe që mund të preken nga rezultati i veprimit administrativ. Projekti “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër”, është projekt i porositur nga Bashkia Këlcyrë, dhe jo produkt i konkurrencës së zgjidhjeve projektuese për zonën qendër Këlcyrë nëpërmjet prokurimit publik për thirrje projektesh me interes publik për zonën qendër Këlcyrë. Nëpërmjet projektit “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër”, Bashkia Këlcyrë ka diskriminuar F.J në mënyrë të tërthortë.

6. Bashkia Këlcyrë nuk e trajton me cilësinë e palës së interesuar F.J, për shkak se projekti “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër” Këlcyrë, kërkonte

prishjen e objektit të tij, duke mos e informuar me informacionin e projektit, procedurën administrative të miratimit të projektit përfshirë këtu takimin dhe këshillimin publik, duke e bërë të pamundur për F.J mbrojtjen e pronës, dhënien e ideve dhe vërejtjeve lidhur me projektaktin, të drejta këto të garantuara me ligj, kur në kundërshtim me qëndrimin e saj ndaj F.J, pretendon se ka kryer seancat e takimit dhe këshillimit publik në lidhje me projektin “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër” Këlcyrë duke ia dhënë këtë mundësi njohjeje palëve të tjera që preken nga projekti, apo publikut.

7. Bashkia Këlcyrë refuzon në vazhdimësi dhënien e informacionit publik rreth projektit “Rijetëzimi i pedonaleve dhe hapësirave rekreative në sheshin Qendër”, të kërkuar nga F.J, kur sipas pretendimeve të saj për këshillimin dhe takimin publik në lidhje me projektin, këtë mundësi ia ka dhënë pjesëmarrësve të këtyre seancave. Pretendimi i Bashkisë Këlcyrë për realizimin e seancave të takimit dhe këshillimit publik në lidhje me projektin, do të thotë që në bazë të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 24, Këshillimi dhe takimi publik, se Bashkia Këlcyrë ka pajisur palët e interesuara dhe publikun me informacionin rreth projektit, pra ia ka mundësuar dhënien e informacionit publik rreth projektit personave që kanë marrë pjesë në seancat e takimit dhe këshillimit publik”.

8. Bashkia Këlcyrë refuzon të zbatojë detyrimet e saj ligjore për zaptimet e truallit dhe ndërtimet e paligjshme kufitare me F.J, në jug të banesës së tij në lagjen e Spitalit Këlcyrë dhe jugperendim të objektit të tij në zonën tregëtare të lulishtes qendër Këlcyrë, dhe qendron në page me këta abuzues të pronës publike dhe ndërtues të paligjshëm. Për të dyja rastet ku ka pronë F.J, jo vetëm që nuk hap rrugën e zaptuar, por i legalizon ata në kundërshtim me ligjin, duke krijuar pabarazi të ekspozuar ndërmjet F.J dhe kufitarit apo personave të tjerë banues të zonës apo më gjerë. Bashkia Këlcyrë refuzon të zbatojë vendimin e KRRT së Qarkut Gjirokastrë, datë 28.03.2003 për hapjen e rrugëve të bllokuara në lagjen e Spitalit Këlcyrë, i cili shoqërohet me planimetrinë e rrugës në jug të banesës së F.J, në të cilën duhet të ndërhyet dhe nuk ndërhyr; refuzon të prishë ndërtimin e paligjshëm të kufitarit të F.J tek objekti në zonën tregëtare të lulishtes qendër Këlcyrë, që ka zaptuar servitutën publik, për më tepër bashkia e legalizon këtë ndërtim të paligjshëm dhe ka kërkuar prishjen e objektit të F.J korrekt me lejen e ndërtimit nëpërmjet një projekti të porositur prej saj.

Lidhur me pretendimin se po diskriminohet për shkak të “vendbanimit”², ankuesi shpjegon se: “Është vendbanimi i tij (banesa dhe objekti në ndërtim) shkak i sjelljes diskriminuese të Bashkisë Këlcyrë, e cila ka krijuar kushte që të mos gëzojë vendbanimin, qytetin e tij, duke i lënë të vetmen zgjidhje, largimin nga vendi. Duhet të kuptohet se pa objektet e tij, F.J nuk mund ta gëzojë qytetin e tij të vogël Këlcyrën, pasi Bashkia Këlcyrë po ia pret dhe mundësitë për të ardhmen e tij në këtë qytet”.

Lidhur me pretendimin se po diskriminohet “për çdo shkak tjetër”, ankuesi shpjegon se: “Mendoj se është qëndrimi i tij politik ndaj lidhësve të partive PD dhe PS (produkt i PP-së). Ky qëndrim ndaj tij nuk ka filluar vetëm aty. Ai nuk mund të sjell fakte, për një ngjarje të rëndë

² Referuar shpjegimeve të dhëna me e-mail datë 24.09.2020.

që ka ndodhur ndaj tij në vitin 2003, nuk mund ta regjistronte, pasi nuk e priste kurrë të ndodhte, kur jeta e tij është kërcënuar seriozisht, pasi kurrë nuk e ka pritur që për shkak të fjalës së lirë dhe lirisë së mendimit do të rrëmbehej dhe terrorizohej në mënyrë të organizuar nën kërcënimin e armës, nga organi shtetëror, duke e pyetur për qëndrimin e tij politik”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe ndalimin e veprimeve diskriminuese nga ana e Bashkisë Këlcyrë.

Pas shqyrtimit paraprak të saj, u konstatua se ankesa e depozituar pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 21.09.2020, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë shpjegime, lidhur me shkakun e pretenduar (vendlindjes dhe çdo shkak tjetër) dhe lidhjes shkakësore ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, gjithashtu i është kërkuar kopje të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjirokastrë.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, ankuesi me e-mail-in datë 24.09.2020 ka dhënë parashtrimet e tij si dhe ka dërguar kopje të vendimit të gjykatës.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet shprehimisht në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe në Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44/2, të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimiteti, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Bazuar në deklaratimet e depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri, konstaton se:

- Së pari, lidhur me pretendimin për moszbatimin e vendimit të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Qarkut Gjirokastrë, datë 28.03.2003, *“Për hapjen e rrugëve të bllokuara në lagjen e Spitalit Këlcyrë”*, subjekti ankues³ është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e Bashkisë Këlcyrë që në periudhën e verës së vitit 2003 kur ka marrë pjesë si palë e interesuar në çështjen gjyqësore të hapur nga J.P i cili ka kundërshtuar vendimin e sipërcituar, gjithashtu ankuesi ka pasë dijeni dhe më vonë kur me datë 12 dhe 18.09.2014⁴, nëpërmjet facebook messenger i ka kërkuar kryetarit të bashkisë të zbatojë vendimin KRRT-së për hapjen e rrugës auto në jug të banesës së tij, e cila rezulton e zaptuar nga pronarët e objekteve.

Së dyti, lidhur me pretendimin për veprimet diskriminuese të Bashkisë Këlcyrë për objektin lokal plus banesë, të miratuar me Vendim nr 1, datë 05.04.2006 të KRRT-së, Komisioneri vlerëson se ankuesi është vënë në dijeni që në vitin 2012, kur Kryetari i Bashkisë Këlcyrë i ka shpjeguar se ishin bllokuar pagesat dhe kontratat për sheshet e ndërtimit dhe më vonë në datë 14.10.2016 kur Kryetari i Bashkisë Këlcyrë i ka kthyer

³ Subjekti ankues deri në vitin 2008 ka qenë punonjës i zyrës së urbanistikës së Bashkisë Këlcyrë.

⁴ Referuar deklaratimeve të bëra në formularin e ankesës, faqe 16, paragrafi i fundit.

përgjigje me mesazh që do e njoftojë për mundësinë e bjerjes së truallit të mbetur të sheshit të ndërtimit dhe më vonë kur ka marrë njoftim nga Bashkia Këlcyrë me shkresat nr. 1377, datë 13.10.2017 dhe nr. 502, datë 07.03.2018 se sheshi i ndërtimit që ka përfituar preket nga një projekt me interes publik dhe i refuzohet kërkesa për zgjatjen e afatit të lejes së ndërtimit. Ankuesi me shkresën nr. 964, datë 09.05.2018 të Bashkisë Këlcyrë është njoftuar se objekti i tij nuk është klasifikuar për zhvillim të mëtejshëm dhe i është kërkuar dokumentacioni për shpronësim.

Së treti, rinovimin e lejes së ndërtimit për të ndërtuar objektin lokal plus banesë të miratuar me Vendimin nr. 33, datë 29.08.2005, projektin për rrijetësimin e pedonales dhe hapësirave rekreative në sheshin qendër Këlcyrë dhe ndalimin e sekuestrimit ose prishjes së objektit të tij ankuesi e ka kundërshtuar gjyqësisht (pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, me datë 21.05.2018), që do të thotë se ankuesi ka marrë dijeni të faktit të diskriminimit të pretenduar pranë KMD-së, të paktën që në muajin maj 2018.

- Në kontekst të sa më sipër, **ankuesi ka marrë dijeni për veprimet e Bashkisë Këlcyrë** (fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin), **që në muajin maj 2018. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 17.09.2020**, pra më vonë se një vit nga marrja dijeni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa e F.J, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Subjekti ankues pavarësisht mos pranimit të ankesës, bazuar në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 34, pika 1, ka të drejtën e ngritjes së padisë në gjykatë pa e lidhur atë me mospranimin e ankesës nga Komisioneri për shkak të procedurës ligjore.

Më konkretisht, sipas nenit 34, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim, 1: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”, 2: “Paraqitja e ankimit

përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale”.

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ju rekomandon që bazuar në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 36, pika 1, *Procedura para gjykatës “Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje”, ti drejtoheni gjykatës kompetente për shqyrtimin e kësaj ankese.*

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh, nenin 33, pika 10, nenin 36, pika 1, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit F.J, për shkak se është jashtë afateve të parashikuara në dispozitat e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA